

LIGJ
Nr. 181/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9665, DATË 18.12.2006, “PËR HUAMARRJEN SHTETËRORE, BORXHIN SHTETËROR DHE GARANCITË SHTETËRORE TË HUAS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

Kuptimi i huamarrjes shtetërore

Huamarrja shtetërore është një veprimtari që realizohet nëpërmjet marrëveshjeve dhe instrumenteve, të cilat përmbajnë rregulla për të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet dhe mënyrat, sipas të cilave shteti shqiptar siguron fonde nga një apo më shumë huadhënës dhe dispozita për shlyerjen e huave.”.

Neni 2

Në nenin 6 bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Menaxhimi i borxhit është veprimtaria shtetërore, qëllimi kryesor i së cilës është sigurimi i fondeve të nevojshme të huamarrjes, duke vlerësuar riskun dhe koston e tij, në këndvështrimin afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe zhvillimin e tregut të titujve të shtetit, nëpërmjet shtimit të instrumenteve të tij dhe zgjerimit të bazës së investitorëve.”.

2. Pas paragrafit të dytë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Ministri i Financave raporton çdo katër muaj në Kuvend, pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, për ecurinë e borxhit shtetëror dhe borxhit të garantuar të shtetit.”.

Neni 3

Në nenin 7, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) Për të financuar nevojat e njërive të qeverisjes vendore dhe të subjekteve të tjera, për qëllim të financimit të projekteve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 4

Në nenin 13 shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Tejkalimi i kufizimeve, të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, nuk mund të cenojë palët e treta (huadhënësit ose mbajtësit e titujve të shtetit, si dhe personat, në favor të të cilëve shteti ka dhënë

garanci shtetërore) dhe në asnjë rast nuk sjell si pasojë pavlefshmërinë e marrëveshjeve përkatëse të huamarrjes apo lëshimit të garancive shtetërore.”.

Neni 5

Titulli i kreut IV ndryshohet si më poshtë:

“Marrëveshjet për borxhin shtetëror dhe garancitë e huas”.

Neni 6

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Procedurat e negociimit dhe miratimit të marrëveshjeve, instrumenteve për huat shtetërore dhe garancitë shtetërore të huas

Ministria e Financave mban kontakte zyrtare të drejtpërdrejta me kreditorët për sigurimin e financimeve nëpërmjet kredive. Në rastet kur për financimin e një projekti, investim publik, merret kredi nga banka private, përzgjedhja e kreditorit bëhet nëpërmjet procedurave të përzgjedhjes, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ministri i Financave negocion dhe vendos për kushtet thelbësore të kontratave të huas në emër të Republikës së Shqipërisë ose të Këshillit të Ministrave.

Për kontratat e kredisë ose të garancisë që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë ose të Këshillit të Ministrave, Ministri i Drejtësisë, me kërkesë të Ministrit të Financave, lëshon një opinion ligjor, i cili vërteton se janë zbatuar të gjitha dispozitat ligjore në fuqi, se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, në kuadër të kontratës, dhe se kontratat janë të ligjshme e mund të hyjnë në zbatim me fuqi të plotë ligjore.

Këshilli i Ministrave miraton procedurat për nënshkrimin, lëvrimin dhe raportimin e huave, të kredive dhe garancive, në emër të Këshillit të Ministrave ose të Republikës së Shqipërisë.

Ministri i Financave ka të drejtë të lidhë kontrata të huamarrjes shtetërore apo të emetojë instrumente borxhi të brendshëm dhe të jashtëm për sa kohë respektohen kushtet e përcaktuara në ligjin për buxhetin vjetor përkatës. Ministri i Financave nuk mund të lidhë kontrata të huamarrjes shtetërore apo të emetojë instrumente borxhi të brendshëm dhe të jashtëm kur tejkalohen kufijtë e huamarrjes, të përcaktuar në ligjin për buxhetin vjetor përkatës. Në rast se lind nevoja të tejkalohen kufizimet e ligjit për buxhetin vjetor, miratimi i tyre bëhet vetëm nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Huamarrja dhe garancitë shtetërore të huas me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare

Për qëllimet e këtij ligji, marrëveshje ndër-kombëtare për huat shtetërore dhe garancitë shtetërore të huas konsiderohen ato marrëveshje që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë ose Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nga Ministri i Financave, me shtete ose organizata ndërkombëtare publike.

Procedurat e negociimit, nënshkrimit, miratimit dhe ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për huat shtetërore dhe garancitë shtetërore të huas kryhen sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Ministri i Drejtësisë, me kërkesë të Ministrit të Financave, lëshon një opinion ligjor, i cili vërteton

se janë zbatuar të gjitha dispozitat ligjore në fuqi, se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, në kuadër të marrëveshjes dhe se marrëveshjet janë të ligjshme e mund të hyjnë në zbatim me fuqi të plotë ligjore.

Neni 8

Në nenin 30, titulli ndryshohet si më poshtë:

“Huadhënia e të ardhurave të borxhit shtetëror”.

Neni 9

Titulli i kreut V ndryshohet si më poshtë:

“Këshilltarët, agjentët fiskalë dhe ndërmje-tësit financiarë të borxhit shtetëror”.

Neni 10

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli ndryshohet si më poshtë:

“Emërimi i këshilltarëve, agjentëve fiskalë dhe ndërmjetësve financiarë të borxhit”.

2. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Ministri i Financave emëron këshilltarët, agjentët fiskalë dhe ndërmjetësit financiarë të borxhit shtetëror. Për qëllim të këtij neni, në përzgjedhjen e këshilltarëve, agjentëve fiskalë dhe ndërmjetësve të borxhit shtetëror nuk zbatohen rregullat e prokurimit publik. Kushtet dhe procedurat për emërimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 24.12.2014